



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 269/2 prot.

Elbasan, më 29.01.2025

VENDIM
Nr. 3 datë 29.01.2025

Për
miratimin e studentëve përfitues të mbështetjes financiare të studentëve në programet e studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", që financohen nga AKFAL

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; VKM-s nr. 386, datë 01.06.2022 "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar, udhëzimit të MAS nr. 30, datë 04.11.2022 për këtë qëllim, shkresës së AKFAL nr. 315/5 prot, datë 26.12.2024 (në UE shkresa nr. 3429 prot, datë 27.12.2024 "Përcillet lista e studentëve, të cilët kanë aplikuar për përfitimin e mbështetjes financiare, në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar, për vitin akademik 2024-2025, shkresës së AKFAL nr. 292 prot, datë 06.11.2024 (në UE shkresa nr. 2857 prot, datë 08.11.2024 "Përcjellet informacion për miratimin e fondit për mbështetjen financiare,për çdo institucion publik të Arsimit të Lartë, sipas kuotave të financimit të miratuara për programet prioritare, për vitin akademik 2024-2025", Vendimi i Senatit Akademik nr. 1, datë 21.01.2025 "Për Mbështetjen financiare të studentëve në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e studentëve që përfitojnë "Mbështetjen financiare të studentëve në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar" në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për 10 studentë me financim nga AKFAL si më poshtë:
2. Efektet financiare nga zbatimi i këtij vendimi, të parashikohen në Planbuxhetin e vitit 2025 me fondet e financuara nga AKFAL në vitin 2024.
3. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Dr. Ardian Durrmishi